

DEKRET
Nr.146, datë 13.3.1992

MBI NDËRPRERJEN E BIRËSIMIT TË TË MITURVE SHQIPTARË NGA SHTETASIT E HUAJ

Me qëllim që të disiplinohen juridikisht birësimet e të miturve shqiptarë nga shtetasit e huaj në përputhje edhe me konventat ndërkombëtare;

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

DEKRETOJ:

1. Të ndërpriten birësimet e të miturve shqiptarë nga shtetas të huaj deri në rregullimin ligjor të këtij problemi.

2. Neni 10 i ligjit nr.3920, datë 21.11.1964 "Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë e Prokurorinë e Përgjithshme të studiojnë dhe përgatisin aktet juridike që rregullojnë birësimin e të miturve shqiptarë nga shtetasit e huaj.

4. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
VILSON AHMETI

PRESIDENTI I REPUBLIKES
RAMIZ ALIA